

CONTINUO LINK

ASTAR EPOKSID, BI-KOMPONENT, I HOLLUESHËM ME UJË, TRANSPARENT, ME FUQI TË LARTË
DEPËRTIMI

Seri 116

PËRSHKRIMI

CONTINUO LINK është astar epoksid bi-komponent i hollueshëm me ujë, transparent, i lehtë për tu aplikuar, me fuqi të lartë depërtimi. Formulimi i veçantë i termogurtësimit me viskozitet shumë të ulët, bazohet në përdorimin e rezinave të veçanta epokside dhe katalitëve specifikë me zverdhje të ulët.

CONTINUO LINK mund të përdoret për konsolidimin dhe mbrojtjen e sipërfaqeve të reja të betonit ose për të përmirësuar funksionin kundra pluhurit dhe duke reduktuar absorbimin e ujit dhe të vajrave.

I përshtatshëm për përdorimin në sipërfaqe horizontale dhe vertikale të magazinave, garazheve, ofiçinave, parkimeve dhe të ngjashme.

Në rastin e përdorimit në sipërfaqe të qarta është e mundur një zverdhje e sipërfaqes në kohë.

CONTINUO LINK është i përshtatshëm vetëm për sipërfaqe të brendshme dhe shfaq emisione (çlirim) shumë të ulëta të substancave organike të paqëndrueshme.

CONTINUO LINK ka rezistencë shumë të lartë ndaj ujit, kripërave neutrale dhe alkaline.

Rezistencë e mirë ndaj sprucimeve aksidentale të acideve të dobëta. Nuk është i përshtatshëm për sipërfaqe që janë subjekt i zhytjeve në ujë. Sistemi CONTINUO është klasifikuar A+ sipas dekretit ministerial francez për cilësinë e ajrit në ambiente të brendshme.

ISTRUKSIONE PËR PËRDORIM

I aplikueshëm në:

- Sipërfaqe të dekoruara me CONTINUO DECO
- Sipërfaqe betoni të reja ose të lyera.

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

- Natyra e lidhësit : Epoksid me katalit specifik
- Solventi: ujë
- Raporti i përzierjes në peshë:
2 pjesë komp. A + 1 pjesë komp. B.
- Dendësia UNI EN ISO 2811-1:
Komponenti A=1.08±0.05 kg/l
Komponenti B=1.04±0.05 kg/l
- Dendësia e përzierjes (A+B) UNI EN ISO 2811-1: 1.07±0.02 kg/l
- Kohëzgjatja e përzierjes (A+B): rreth 60 minuta në 20 °C.
- Përzierja (A+B) edhe nëse është ende e lëngët nuk duhet të përdoret përtej kësaj kohe.

-Ngurtësia në aplikim: min 12% - max 14% në varësi të hollimit të përdorur.

-Aspekti me shkëlqim

-Spesori i thatë për shtresë: 8-15 mikron

-Tharja (në 25 °C dhe 65% U.R.): prekja pas 4 orësh, e kompletuar pas 8 orësh.

Sipërfaqja mund të jetë subjekt i trafikut të lehtë pas 16 orësh, tërësisht e kalueshme pas 3 ditësh.

Mund ti kalohet një shtresë tjetër CONTINUO LINK pas 24 orësh dhe jo më shumë se 48 orë.

PËRGATITJA E SIPERFAQES

Sistemi dekorativ CONTINUO: shikoni instruksionet në skedën teknike bashkangjitur.

Dysheme betoni CLS:

- Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e tharë mirë dhe të ketë një kohë maturimi prej të paktën 28 ditësh.

-Kontrolloni gjendjen e sipërfaqes, çarjet dhe plasaritjet mund të trajtohen me produkte specifike.

-Kontrolloni gjendjen e pjesëve të trajtuara më parë.

Pjesët që nuk janë aderuar mirë duhet të hiqen.

-Depozitimet e pluhurit, smogut, vajrave, yndyrnave dhe të tjerë ndotës duhet të hiqen me zmerilim të lehtë ose me detergjentë specifikë.

-Në sipërfaqe të tharë vazhdoni me aplikimin e CONTINUO LINK sipas udhëzimeve të përshkruara.

UDHËZIME PËR APLIKIM

Kushtet e ambientit dhe të sipërfaqes
Temperatura e ambientit: Min. +8 °C / Max. +45 °C

Lagështira relative e ambientit: <85%
Temperatura e sipërfaqes: Min. +5 °C / Max. +45 °C

Lagështira e sipërfaqes: <10%

-Mjetet: pinel, rrul me qime mesatare, spruco të përshtatshëm ose Airless.

Produkti i përfuar nga përzierja A + B, normalisht do të hollonhet duke shtuar 4 litra ujë për 1 litër produkt të gatshëm për punim (A+B). Në prani të sipërfaqeve veçanërisht absorbuese keshillohet hollim me ujë duke shtuar 3 litra ujë për 1 litër produkt të gatshëm për punim (A+B).
-Mos shtoni më shumë ujë për të zgjatur jetëgjatësinë.

CONTINUO LINK

ASTAR EPOKSID, BI-KOMPONENT, I HOLLUESHËM ME UJË, TRANSPARENT, ME FUQI TË LARTË
DEPËRTIMI

Seri 116

-Përzieri (katalizoni) dhe përdorni një paketim për një herë (komp. A + komp. B).
-Nr. I shtresave: 1 shtresë.
-Për të shmangur formimin e hijeve, aplikoni produktin në vazhdimësi, duke shmangur prekjen me rrul ose pinel të sipërfaqes së aplikuar ndërkohë që filmi thahet.
-Pastrimi I mjeteve duhet të bëhet menjëherë me ujë pas përdorimit.
-Shkalla e mbulimit: influencohet shumë nga natyra e produktit që do mbulohet. Për sipërfaqe lisho mesatarisht absorbuese mbulon 15-18 m²/l për shtresë (produkt I holluar).

SAN MARCO GROUP garanton që informacionet e kësaj skede janë marrë nga eksperiencia e saj dhe nga njohjet e saj teknike dhe shkencore; megjithatë nuk mund të mbajë asnjë përgjegjësi për rezultatet e arritura duke qenë se kushtet e aplikimit janë jashtë kontrollit të saj. Këshillohet të verifikohet gjithmonë efikasiteti I produktit. Skeda e paraqitur anulon dhe zëvendëson çdo skedë të mëparshme. Për informacione të mëtejshme teknike kontaktoni në nr.pa pagesë të Asistencës Teknike 800853048.

NGJYROSJA

Produkti është I disponueshëm neutro, nuk ngjyroset.

MAGAZINIMI

Temperatura maksimale e ruajtjes: +30°C
Temperatura minimale e ruajtjes: +5°C
Produkti preferohet të përdoret brenda 2 vitesh nga data e prodhimit, nëse është ruajtur në ambalazh origjinal të pahapur dhe në kushte në temperaturë të përshtatshme.

UDHËZIME SIGURIMI

Vlera limite BE (Dir. 2004/42/EC)
Kat. A/j: bojë bikomponente me performancë të lartë (bazë uji): 140 g/l (2010)
Produkti permban max: 140 g/l VOC
Përdoreni produktin sipas normave aktuale të higjienës dhe sigurisë; pas përdorimit mos I hidhni mbetjet në ambient. I lini të thahen dhe I trajtoni ato si mbetje të veçanta. Mos I hidhni mbetjet/ambalazhet në kanalizime, terren.
Për më shumë informacion konsultohuni me skedën e sigurisë.

SPECIFIKIMET

Astar Epoksid bi-komponent I hollueshëm me uje, transparent, I lehtë në aplikim me fuqi të lartë depërtimi.
Finiturë epokside bikomponente bazë uji për dysheme.
Aplikimi në 1 shtresë me një rreze prej 15-18 m²/l produkt të holluar për shtresë.
Furnizimi dhe instalimi i materialit €
për m².